

**MBI NDËRHYRJET NË TREGUN E PARASË DHE NË TREGUN VALUTOR,
GJATË TREMUJORIT TË DYTË TË VITIT 2025**

1. NDËRHYRJET E BANKËS SË SHQIPËRISË NË TREGUN E PARASË, GJATË TREMUJORIT TË DYTË TË VITIT 2025

1.1. Operacione të tregut të hapur dhe faktorët që kanë ndikuar mungesën e likuiditetit në sistemin bankar

Tabelë 1: Veprimet e përkohshme të tregut të hapur (në miliardë lekë¹.)

DATA	R/REPO njëditore	R/REPO njëjavore	R/REPO >1javë <3muaj	REPO Njëditore	Totali i likuiditetit të injektuar
03-prill-25		25.31			25.31
10-prill-25		24.01			24.01
17-prill-25		27.02			27.02
24-prill-25		30.00			30.00
02-maj-25		28.87			28.87
08-maj-25		27.67			27.67
15-maj-25		23.07			23.07
22-maj-25		45.29			45.29
29-maj-25		46.65			46.65
05-qershor-25		33.02			33.02
12-qershor-25		40.23			40.23
19-qershor-25		45.34			45.34
24-qershor-25			4.03		49.37
26-qershor-25		51.34			55.37

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në tremujorin e dytë të vitit 2025, ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë konsistuan në operacionet e tregut të hapur për injektim likuiditeti.

Injektimi mesatar ditor, nëpërmjet operacioneve injektuese të likuiditetit me maturim 1-13 javë, ka rënë lehtë në 26.93 miliardë lekë, kundrejt 27.80 miliardë lekë në 3-mujorin e parë. Në një krahasim që merr në konsideratë sjelljen sezonale, mungesa e likuiditetit ka rënë me rreth 62%, nga 43.67 miliardë lekë në 26.93 miliardë lekë. Ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në


¹ Shifrat janë në vlerë likuiditeti.

Mbi ndërhyrjet në tregun e parasë dhe në tregun valutor gjatë tremujorit të dytë të vitit 2025


tregun valutor kanë arritur të kenë ndikim të qëndrueshëm në uljen e mungesës, pavarësisht rritjes së parasë në qarkullim me ritme të larta gjatë vitit të fundit. Mungesa ka pasur luhatshmëri të ulët deri në mes të muajit maj, në vlerat 23-30 miliardë lekë, dhe është rritur shpejt prej datës 22 maj deri në fund të periudhës, në 55.40 miliardë lekë.

Ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun valutor nëpërmjet ankandeve, kanë rritur likuiditetin me 5.69 miliardë lekë, ndërsa shitjet e valutës Ministrisë së Financave e kanë ulur likuiditetin në llogarinë e qeverisë me 5.45 miliardë lekë, duke pasur ndikim të papërfillshëm në mungesën e likuiditetit. Gjatë muajit qershor, **Banka e Shqipërisë ka blerë valutë, në përmbushje të objektivave të politikës monetare ose të stabilitetit financiar në kundravleftën në lekë të 7.13 miliardë lekëve, por për shkak të përqendrimit të blerjeve në dy javët e fundit, ndikimi në rënien e mungesës pritet të reflektohet në 3-mujorin e tretë.**

Grafik 1. Ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë, në periudhën 2016-2025 (me vlerë nominale)



Mbi ndërhyrjet në tregun e parasë dhe në tregun valutor gjatë tremujorit të dytë të vitit 2025



Burimi: Banka e Shqipërisë.

1.2 Përdorimi i operacioneve lehtësuese të përhershme

Për shkak të limiteve të pamjaftueshme të tregtimit, përdorimi i instrumentit të depozitës ka qenë i lartë në pjesën e parë të periudhës, në maksimalisht 17.55 miliardë lekë, për të rënë gradualisht deri afër 0 në muajin qershor. Shuma mesatare e depozitave ka rezultuar 4.30 miliardë lekë, me një rënie nga 3-mujori i parë, kur ishin 18.40 miliardë lekë.


Instrumenti i kredisë është përdorur në 14 raste, kundrejt 17 rasteve në tremujorin e parë.

1.3 Operacionet strukturore për menaxhimin e likuiditetit të sistemit bankar dhe portofolit të Bankës së Shqipërisë

Gjatë tremujorit dytë të vitit 2025, Banka e Shqipërisë nuk ka kryer operacione të blerjes apo shitjes së titujve dhe ka mbajtur portofolin të pandryshuar në nivelin 59.57 miliardë lekë.

Vlera e portofolit të bonove të thesarit të Bankës së Shqipërisë, prej 59.57 miliardë lekësh, është niveli më i ulët prej vitit 2019 dhe, në tema relativë, kundrejt borxhit publik të emetuar në monedhën kombëtare, madhësia e portofolit është nën 8.00%, krahasuar me rreth 25% në fillim të viteve 2000.

Mbi ndërhyrjet në tregun e parasë dhe në tregun valutor gjatë tremujorit të dytë të vitit 2025



Burimi: Banka e Shqipërisë.

1.4 Përdorimi i operacioneve rregulluese

Gjatë periudhës, është zhvilluar një operacion rregullues për shumën 3.50 miliardë lekë, në muajin qershor.

2. NDËRHYRJET E BANKËS SË SHQIPËRISË NË TREGUN E BRENDSHËM VALUTOR, GJATË TREMUJORIT TË DYTË TË VITIT 2025

2.1 Veprime me bankat e nivelit të dytë

Gjatë tremujorit të dytë të vitit 2025, sikurse është lajmëruar në dhjetor 2024, me objektiv rritjen e rezervës valutore, Banka e Shqipërisë ka zhvilluar shtatë ankande për blerjen e valutës; në përputhje me objektivin e zhvillimit të tregut, dy kanë qenë me opsionin FORWARD me afat 1 muaj dhe dy të tjerë me afat tre muaj.

Kalendari i ndërhyrjeve - Viti 2025		
	Data	Shuma Raundi I (në euro)
1	2/17/2025	5-10 mln
2	3/13/2025	5-10 mln 3 mo FW
3	3/25/2025	5-10 mln
4	4/11/2025	5-10 mln 1 mo FW
5	4/25/2025	5-10 mln
6	5/16/2025	5-10 mln 3 mo FW
7	5/23/2025	5-10 mln
8	6/5/2025	5-10 mln 1 mo FW
9	6/13/2025	5-10 mln
10	6/20/2025	5-10 mln 3 mo FW
11	7/11/2025	5-10 mln
12	7/18/2025	5-10 mln
13	7/25/2025	5-10 mln
14	8/8/2025	5-10 mln
15	8/15/2025	5-10 mln 3 mo FW
16	8/22/2025	5-10 mln
17	9/19/2025	5-10 mln
18	10/10/2025	5-10 mln 1 mo FW
19	10/20/2025	5-10 mln
20	11/20/2025	5-10 mln 1 mo FW
21	12/5/2025	5-10 mln
22	12/19/2025	5-10 mln 3 mo FW

** Në rastet kur ankandi bie në ditë pushimi, ankandi do të organizohet në ditën pasardhëse të punës.*

Në shtatë ankandet e zhvilluara gjatë periudhës, janë blerë 88.90 milionë euro, pas 33.20 milionë eurove të blera në tremujorin e parë. Shuma e blerë në gjashtë muajt e parë të vitit është 122.10 milionë euro.

Gjatë tremujorit të dytë, prej datës 9 maj 2025, Banka e Shqipërisë ka blerë, në përmbushje të objektivave të politikës monetare dhe stabilitetit financiar, 72.70 milionë euro.

2.2 Veprime me institucione të tjera

Pas maturimit në tremujorin e dytë të vitit 2024, Ministria e Financave nuk ka përdorur marrëveshjet SWAP me Bankën e Shqipërisë.

Gjatë tremujorit, i janë shitur Ministrisë së Financave 42.00 milionë USD dhe 22 milionë SDR ose rreth 62 milionë euro, duke e çuar totalin e shitjeve të gjashtë muajve të parë të vitit në 88.50 milionë USD dhe 57.00 milionë SDR ose rreth 141.6 milionë euro.

Në veprime të tjera: janë blerë 4.95 milionë euro nga IBRD-ja.